



PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS THIRRJA IV

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall hapjen e thirrjes së katërt të Programin Kombëtar të Praktikave të Punës.

Afati për aplikim është nga data 8 shkurt deri më datë 28 shkurt 2019.

Aplikimi është i hapur për të rinjtë profesionistë nga mosha 21 deri 26 vjeç, të cilët zoterojnë minimalisht një diplomë Bachelor.

Kohëzgjatja e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës do të jetë tre muaj.

Profilet e kërkuara, numrin e pranimeve si dhe detaje të tjera i gjeni në linkun e posaçëm. <http://praktika.arsimi.gov.al/>

Pjesëmarrësit do të përfshihen në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo dhe shoqëritë tregtare, me qëllim përfitimin e një përvojë kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre në praktikë.

Dokumentet për aplikim

- a- CV e aplikantit;
- b- Diploma e përfundimit të studimeve të shkollës së lartë;
- c- Lista e notave;
- d- Një letër motivimi.

Aplikimi do të bëhet online në linkun: <http://praktika.arsimi.gov.al/>